



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-
Komisioni i Konkurrencës

VENDIM
nr.361, datë 11.05.2015

“Për
hapjen e hetimit paraprak në tregun e shërbimeve të hotelerisë”

Komisioni i Konkurrencës, me përbërjen e:

Lindita	MILO(LATI)	Kryetar
Servete	GRUDA	Zv/Kryetare
Koço	BROKA	Anëtar
Iva	ZAJMI	Anëtare
Eduart	YPI	Anëtar

Në mbledhjen e datës 11/05/2015, me pjesmarrjen e Znj. Servete Gruda, Znj. Iva Zajmi, Z. Koço Broka, Z. Eduard Ypi, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Ankesa e ndërmarrjes hoteliere “Geci” Sh.p.k, mbi fiksimin e çmimeve të shërbimeve hoteliere dhe praktika të bashkërenduara ndërmjet disa ndërmarrjeve.

Baza ligjore: Ligji nr.9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, nenet: 42 dhe 24, germa d; Neni 9, pikat 1 dhe 2 të Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës” dhe neni 4 i Rregullores “Për procedurat hetimore të Autoritetit të Konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të ankeses se “Geci” Sh.p.k, dhe kërkesës së njërit nga Komisionerët mbi hapjen e hetimit paraprak sipas kesaj ankese ,

VËREN SE:

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, më datë 26.03.2015, shoqëria “Geci” Sh.p.k, me shkresën nr. 172 prot. ka paraqitur një ankesë, ku i drejtohet Autoritetit të Konkurrencës në lidhje me shqetësimin mbi disa “*çmime të ngurtësuara dhe të fiksuara të shërbimeve të hotelerisë, si dhe mbi disa praktika të bashkërenduara në caktimin e tyre dhe ndarjen e tregjeve të këtyre shërbimeve*”.

Ankuesi bën me dije se gjatë vitit të fundit, nga disa hotele në Tiranë, Sarandë etj., janë kryer shkelje të Ligjit nr.9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, duke përdorur pranë emrit të tyre jo vetëm emrin “Tirana Hotel”, por është konstatuar edhe ofrim i shërbimeve prej

tyre me çmime të ngurtësuarra dhe të fiksuara, si dhe me praktika të bashkërenduara në caktimin e tyre dhe ndarjen e tregjeve të këtyre shërbimeve. Ankimuesi ka plotësuar “Formularin e ankesës” dhe e ka paraqitur pranë Autoritetit të Konkurrencës me shkresën nr. 172/2 prot, datë 01.04.2015.

Për sa më lart, në zbatim të Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” ekziston mundësia e një marrëveshje të ndaluar në formën e fiksimit të çmimeve të shërbimit të hotelierisë si pasojë e marrëveshjeve dhe/ose praktikave të bashkërenduara ndërmjet dy ose më shumë ndërmarrjeve hoteliere vepruese në tregun përkatës, sipas parashikimeve të nenit 4 të Ligjit nr.9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e Konkurrencës”, (i ndryshuar).

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në ankesën e shoqërisë “Geci” Sh.p.k dhe me propozimin e një antari të Komisionit, bazuar në nenet: 3 (pika 4), 24 (germa *d & f*), dhe 42 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, (i ndryshuar),

VENDOSI:

- I. Hapjen e hetimit paraprak në tregun përkatës të shërbimeve hoteliere në territorin e Shqipërisë, për të hetuar mbi mundësinë e ekzistencës (ose jo) të shkeljeve në trajtën e praktikavë të bashkërenduara dhe fiksimeve të çmimit në këtë treg.
- II. Periudha hetimore do përfshijë gjithë vitin 2014 ndërkohë që procedura e hetimit paraprak do të përfundojë jo më vonë se 3 muaj nga dalja e këtij vendimi.
- III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi sipas parashikimeve të Ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMISIONI I KONKURRENCES

Servete GRUDA

(_____)
Zv/Kryetar

Koço BROKA

(_____)
Anëtar

Iva ZAJMI

(_____)
Antar

Eduard YPI

(_____)
Anëtar

Lindita MILO(LATI)

KRYETAR